



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.16, datë 28 .02. 2013

**“PËR
NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK
TË TIRANËS NR.53, DATË 24.12.2012, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESËM 2013-2015 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË
SË TIRANËS PËR VITIN 2013”**

Në mbështetje të nenit 19, pika 9 dhe nenit 32, gërma “dh” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 39, 44 paragrafi i dytë shkronja “a” të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr.7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar); udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 për “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.53, datë 24.12.2012, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2013-2015 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2013”; shkresës nr.20413/32 datë 07.01.2013 të Ministrisë së Financave për transfertën e pakushtëzuar të vitit 2013, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë një shtesë në pikën 1.1 të vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.53, datë 24.12.2012, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2013-2015 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2013”, në shumën totale **527,570,225 lekë të përberë nga:**
 - a-fondi i mbartur nga viti 2012**, sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit të Tiranës në shumën 363,815,320 lekë,
 - b- shtesa në transfertën e pakushtëzuar** të vitit 2013 në shumën 163,754,905 lekë detajuar sipas pasqyrës nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Në zbatim të pikës 1/b, të miratojë ndarjen në 3-mujorë të shtesës së transfertës së pakushtëzuar të vitit 2013, sipas aneksit nr.1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të miratojë një shtesë në pikën 1.1 të vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.53, datë 24.12.2012, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2013-2015 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2013”, të fondit të trashëguar nga granti i përfituar në vitet e mëparshme, në shumën 5,603,322 lekë, si dhe të fondit të mbartur nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve në shumën 762,151 lekë, detajuar sipas pasqyrës nr.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve ndërmjet programeve për Njësitë Bashkiake nr.5 dhe nr.6 si dhe rishpërndarjen e fondeve brenda programit të Shërbimeve Publike për Drejtorinë e Përgjithshme nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, sipas pasqyrës nr.3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, të kryejë sistemimet në buxhetin e vitit 2013 në të ardhurat dhe shpenzimet sipas pikave 1, 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi.
6. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Prokurimeve, Drejtoria e Financës, Njësitë Bashkiake 1-11, Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, Qendra Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, Qendra Kulturore “Tirana”, Agjensia e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Njësia e Menaxhimit të Projekteve, për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI

